



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 121 Datë 02.10.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”**, **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “**, **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”**, **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe Vendimit Këshillit Bashkiak Dibër **nr. 76 prot datë 02. 08. 2017, pika I**, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, Këshilli Bashkiak vendosi me datë 02.10.2020 me 17 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Ramadan Drenova** njësia administrative Luzni (fshati Katundi Ri) në shumën totale **199455** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **115555** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **83900** lekë.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **99727** lekë (50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli
Sokol SAVA



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUPI”, Peshkopi, [email:bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) nr.tel:0035521822935